

## Thirrje për aplikime për bursë për përfundimin e arsimit të mesëm

Këshilli Danez për Refugjatë (DRC) hapi një thirrje për aplikime për bursa për të **rinjtë dhe të rejtat nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë** për përfundimin e shkollës së mesme. Bursat do t'u jepen të rinjve që përfaqësojnë grupet etnike të lartpërmendura, të cilët kanë përfunduar plotësisht shkollën fillore dhe/ose kanë braktisur shkollën e mesme dhe që kanë një vullnet të fortë për të përfunduar arsimin e mesëm dhe do të jenë të përkushtuar ndaj kërkesave të bursave.

Bursa do të mbulojë tarifat e studimit dhe materialet mësimore për kandidatët e kualifikuar gjatë një viti akademik, si dhe nëse është e nevojshme, një pagesë ditore dhe shpenzimet e transportit.

Nga ky program bursash mund të përfitojnë të gjithë ata që janë të interesuar të përfundojnë arsimin e mesëm profesional dhe përmbushin kriteret e pranueshmërisë të listuara më poshtë. Të rinjtë dhe të rejtat që, për çfarëdo arsye, kanë braktisur arsimin e mesëm inkurajohen të aplikojnë.

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë i ri ose e re pjestarë/e të komuniteteve rom, ashkali ose egjiptian (18-35 vjeç);
- Të jetë banor i njërës nga komunat në regjionet e Mitrovicës ose Prishtinës;
- Të ketë dëftesë për përfundimin e shkollës fillore ose të përfundimit të ndonjë klase nga shkolla e mesme;
- Prindërit të jenë përfitues të ndihmës sociale nga qendra e mirëqenies sociale, ose prindërit tuaj janë të papunë.

Të gjithë aplikantët janë të ftuar të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- Një kopje e certifikatës së përfundimit të shkollës fillore.
- Një kopje e certifikatës së klasave të shkollës së mesme (nëse ka të përfunduar).
- Një kopje valide të letërnjoftimit.
- Një kopje e vërtetimit se janë përfitues të skemës sociale.

Dokumentet e kërkuara duhet të dërgohen në email adresën: [xkx-projectassist@drc.ngo](mailto:xkx-projectassist@drc.ngo) duke shënuar "**Aplikimin për Programin e Bursave**" në subjektin e emailit deri më **30/06/2023 në orën 17:00**.